# DËSHMI ARKIVI

**A-470720**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Sot Shqipëri-Bjellorusi! Policia publikon planin e masave të sigurisë, ja rrugët që do të bllokohen |
| ADRESA | `https://piranjat.al/sport/sot-shqiperi-bjellorusi-policia-publikon-planin-e-masave-te-sigurise-ja-rr-i106144` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 07:27:31 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 07:17:11 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `422e9651285e9aa2fde27835f516c9cc3d830f55005459ac97c267a9d0507950` |
| TEKSTI | `10e93859c04fd8180a5c0a78bb5e251255ad8d53eca68a293754a02a29e1d369` |
| PAMJA | `b691dbadf6a1c90f770f30e10064ef6f5c0811ac2d1742a858ccfc773b16256b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c9a4cf8dc0f0330ddb889b5471506757e00a708f84ecee1029923f172d09cfe5` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a38a4fa799b1e73bbabeaa0ef113694411dbd892b18eb619eb2f3db166512539` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c9a4cf8dc0f0330ddb889b5471506757e00a708f84ecee1029923f172d09cfe5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SPORT

# Sot Shqipëri-Bjellorusi! Policia publikon planin e masave të sigurisë, ja rrugët që do të bllokohen

Piranjat Përditësimi i fundit 26 Shtator 2026, 09:17



Në kuadër të ndeshjes ndërkombëtare të futbollit ndërmjet kombëtareve të Shqipërisë dhe Bjellorusisë, e cila zhvillohet mbrëmjen e sotme në orën 20:45 në stadiumin "Air Albania", Policia e Shtetit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake të Tiranës ka hartuar një plan të detajuar masash për garantimin e rendit dhe sigurisë publike.

Për të lehtësuar qarkullimin e mjeteve dhe për të parandaluar çdo incident para, gjatë dhe pas sfidës, autoritetet do të aplikojnë kufizime të lëvizjes së automjeteve në disa prej akseve kryesore në afërsi të stadiumit, duke filluar nga ora 17:00 e ditës së sotme (26 shtator 2026) e deri në përfundim të aktivitetit.

Gjatë këtij orari do të bllokohet qarkullimi i automjeteve në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit" nga fast food-i "Laguna" pranë urës së ish-Hotel Dajtit, në rrugën "Papa Gjon Pali II" te kryqëzimi i RTSH-së, si dhe në rrugët "Dervish Hima" e "Asim Zeneli" pranë Ambasadës së SHBA-së. Po ashtu, kufizime do të ketë në hyrje të rrugës "Themistokli Gërmenji", te kryqëzimi i rrugës "Ismail Qemali" me RTSH-në, si dhe në rrugën "Abdyl Frashëri" pranë Librit Universitar. Rruga "Lekë Dukagjini" pranë ish-Gardës do të shërbejë vetëm si korridor hyrës për parkimin e mjeteve të autorizuara nga FSHF-ja, ndërsa te sheshi "Willson" lëvizja do të devijohet drejt rrugës "Sami Frashëri" pak para përfundimit të ndeshjes. Rruga e Elbasanit, Unaza e Qytetit dhe bulevardi "Bajram Curri" do të mbeten plotësisht të lira për qarkullim.

Policia e Shtetit njofton se portat e stadiumit do të hapen që në orën 18:30 për të shmangur radhët e gjata. Efektivët do të ushtrojnë kontrolle të imtësishme ndaj të gjithë tifozëve para futjes në tribuna, duke ndaluar kategorikisht futjen e banderolave me përmbajtje raciste, lëndëve piroteknike si fishekzjarret e flakadanët, si dhe objekteve të forta apo të rrezikshme përfshirë monedhat metalike, çadrat, çakmakët, karikuesit e celularëve dhe produktet kozmetike. Për këtë aktivitet sportiv janë angazhuar qindra punonjës policie për të garantuar që çdo gjë të përmbyllet pa incidente.

## Artikuj te sugjeruar

SPORT 25 Shtator23:12

### Gjimshiti para Shqipëri-Bjellorusi: Synojmë të shkojmë për herë të tretë në Europian

Në prag të sfidës së parë zyrtare ndaj Bjellorusisë, përpara mediave doli edhe kapiteni i Shqipërisë, Berat Gjimshi...

SPORT 25 Shtator22:31

### Yamal zbulon sekretin e të qenit në formë: Ja kur luaj më mirë

Në moshën 19-vjeçare, talenti i Barcelonës, Lamine Yamal, është etablishtuar si njëri prej futbollistëve më t&eum...

SPORT 25 Shtator21:56

### Muriqi ngjitet në mesin e golashënuesve më të mirë të Ligës së Kombeve, lë pas yje të mëdhenj

Sulmuesi dhe kapiteni i Kosovës, Vedat Muriqi, vazhdon të shkruajë emrin e tij në historinë e Ligës së Kombeve, duke u rendit...

SPORT 25 Shtator19:32

**[“Dua të jem bodibilder deri sa të vdes”/ Japonezi 90-vjeçar stërvitet gjashtë ditë në javë dhe vazhdon të fitojë tituj]**

Në moshën 90-vjeçare, Toshisuke Kanazawa vazhdon të ngrejë pesha, të marrë pjesë në gara dhe të fitojë ...

SPORT 25 Shtator19:27

**[Skandali i falsifikimeve prek një tjetër lojtar të Zvicrës, pas Xhakës edhe Embolo jashtë ekipit për mashtrim]**

Skandali i certifikatave të rreme të vaksinimit trondit sërish Kombëtaren e Zvicrës, teksa pas Granit Xhakës, një tjetër...

SPORT 25 Shtator18:55

**[Kombëtarja mbyll përgatitjet për ndeshjen ndaj Bjellorusisë, mungon një nga lojtarët]**

Kombëtarja shqiptare do të zbresë nesër në fushë për të nisur rrugëtimin në UEFA Nations League, me ndeshjen e...

SPORT 25 Shtator18:24

**[“Hiqni sytë nga Broja”, ish-mbrojtësi i kombëtares: E kemi pritur për 4 vite, duhet të kërkonim një talent si Gruda]**

Ish-mbrojtësi i Kombëtares shqiptare, Kreshnik Çipi, ka bërë një deklaratë të fortë në lidhje me Armando Bro...

SPORT 25 Shtator15:52

**[Alcaraz kërkon ndryshime! Tenisti kundër fundit të ndeshjeve të pas mesnate në Grand Slam]**

Carlos Alcaraz kërkon ndryshime në programin e turneve Grand Slam, pas përfundimit të vonë të ndeshjeve në US Open. Spanjol...

SPORT 25 Shtator15:47

**[Bjellorusia, testi zyrtar për trajnerin Maran: Shqipëria më emocionon dhe më bën krenar]**

Në konferencën për shtyp, Maran pritet të zbulojë më shumë për mënyrën se si do ta ndërtojë skuadr...

SPORT 25 Shtator15:40

**[Havertz dhe Musiala largohen nga grumbullimi i Gjermanisë, Klopp thërret Wirtz]**

Kombëtarja e Gjermanisë ka pësuar dy mungesa të rëndësishme në prag të ndeshjeve të radhës, pasi Kai Havertz...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 25 Shtator

**[“Më quajti lopë kur isha shtatzënë”/ Pas videos...]**

Një situatë e paprecedentë raportohet të ketë ndodhur një muaj më parë në qytetin e Durrësit, ku shefi i Kom...

SHOWBIZ 25 Shtator

**["Fjeta milioner dhe u zgjova i rrënuar", Robert...]**

Roberto Carlos ka rrëfyer një nga periudhat më të errëta të jetës së tij, duke zbuluar kalvarin me të cilin u p&eum...

AKTUALITET 25 Shtator

**[''Bleona është gjallë!''/ Gjyshi rrëfen misteri...]**

Prej 16 vitesh, fati i Bleona Matës mbetet i pazbardhur. Vajza vetëm 6 vjeçe humbi gjurmët më 22 maj 2010 në Zapod të Kuk...

INVESTIGIME 25 Shtator22:29

**[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!]**

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

## video





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2**





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2**



**Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!**



**Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.**





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.